

15 nëntor 2007

Komunikatë për media

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën e 30-të të Privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot zyrtarisht shpalli valën e 30-të të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 1 Nëntor, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitatet përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet www.kta-kosovo.org.

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës së 30-të janë përfshirë 9 NSH, nga të cilat janë krijuar 10 Ndërmarrje të Reja.

Të gjitha Ndërmarrjet e Reja do të privatizohen përmes spinofit të rregullt.

Afati për para-kualifikim është deri me 16 janar 2008.
Dita për dorëzimin e ofertave është me 23 janar 2008.

Lista e plotë e Ndërmarrjeve të Reja të shpallura në këtë valë:

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore në Nec 2 Sh.P.K. - prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në afërsi të fshatit Sllatinë, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 45 ha. Pjesa më e madhe e tokës është përdorur për kultivimin grurit dhe drithërave. Sidoqoftë shumica e tokës nuk është kultivuar rregullisht në vitet e fundit.

Ndërmarrja e Re Grafikos Sh.P.K. - është një shtypshkronjë e madhe që merret me shërbimet kontraktuese, e cila gjendet në afërsi të qendrës së Gjilanit. Asetet kryesore të Ndërmarrjes së Re përbëhen nga reputacioni, biznesin dhe klientët e Grafikos si dhe shtypshkronjën që gjendet në qytetin e Gjilanit që së bashku me objektin e administratës përbëjnë 1,433 m². Objekti është i ndërtuar në vitin 1977 dhe është në gjendje të mirë. Sipërfaqja totale e tokës brenda rrethojës është 3,510 m².

Ndërmarrja e Re Kooperativa Bujqësore Turigevci Sh.P.K. - ofron investuesve potencial një mundësi të shkëlqyer për çfarëdo lloj biznesi, duke përfshirë 4,329m² tokë, disa ndërtesa si dhe një lokacion të përshtatshëm në fshatin Turigevc, Regjioni i Skenderajit.

Ndërmarrja e Re Nevolan Sh.P.K. - tokë bujqësore, me lokacion në fshatin Nevolan, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 25 hektar tokë.

Ndërmarrja e Re Bujqësia - Tokë Bujqësore Sverka Sh.P.K. - e propozuar ndodhet në Komunën e Klinës. Sipërfaqja e tokës në këtë ofertë përfshin rreth 85.3 hektarë të tokës bujqësore që ndodhen në zonat kadastrale Kliqinë dhe Sverkë të Komunës së Klinës.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Kliqina Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial të blejë toke bujqësore me sipërfaqe prej përrreth 78.5 ha. të cilat zonat kadastrale Kliqinë dhe Sverkë të Komunës së Klinës

Ndërmarrja e Re Fryti Sh.P.K. - asetet e Ndërmarrjes përveç ndërtesës administrative dhe depove, përfshijnë edhe pasuritë tokësore me rreth 1 06 52 h

Ndërmarrja e Re Separacioni Gadime Sh.P.K. - kjo Ndërmarrje e Re gjendet në Gadime, Komuna e Lipjanit, dhe përfshin tokën prej 62,904 metrash katrorë. Ndërmarrja në të kaluarën ka qenë e përbërë prej "Minierës së Linjtit" e cila nuk punon që nga viti 1990 dhe "Seperacionit të Gurëve". Kjo Ndërmarrje prodhon Fraksione të Gurit dhe Filer (pluhur guri) që nevojitet më së shumti për ndërtimin e rrugëve.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj Sh.P.K. - investuesit potencial i ofron një mundësi të shkëlqyer për të përvetësuar tokë shumë të mirë bujqësore shumica e së cilës tokë është nën infrastrukturën e ujitjes të Kompanisë së Ujitjes Ibër Lepenc. Ndërmarrja përbëhet prej rreth 298 hektarësh të tokës bujqësore të ndarë në këto zona kadastrale: Shkabaj/Orloviq, Prishtinë, Krushefc, Fushë Kosovë.

Ndërmarrja e Re po ashtu ka njësinë për servisimin e makinerisë me makinerinë bujqësore në fshatin Shkabaj.

Ndërmarrja e Re Pylltaria Suharekë – Ndërtesa Administratës Sh.P.K. - prona e ndërmarrjes për tu bartur në subjektin e ri përmban godinën administrative që ndodhet afër tregut në Suharekë dhe përmban një sipërfaqe prej përafërsisht 0,33,44 ha.